



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE

RAPORT

PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË
“HEC ULEZ SHKOPET SHA”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për privatizimin e shoqërisë “HEC ULEZ SHKOPET SHA”, e krijuar me Urdhërin Nr.783 datë 18.12.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për privatizimin e shoqërisë “HEC Ulez Shkopet Sh.A”, bazuar në Raportin e Konsulentit për vlerësimin e ofertave për privatizimin e Shoqërisë HEC Ulez Shkopet Sh.A dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.677, datë 3.10.2012 “Për një ndryshim në Vendimin Nr.153, datë 29.2.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë për shitjen e 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare “HEC Ules Shkopet SHA”, (referuar si VKM Nr. 677) paraqet Raportin Përfundimtar të Vlerësimit të Ofertave .

Në procesin e tenderit të mbajtur më 21 Dhjetor 2012, ora 12.00 am pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, u morën ofertat e mëposhtme për privatizimin e Shoqërisë “HEC Ules Shkopet SHA” të renditura sipas vlerës financiare:

1. Kurum International Sh.A	57.5 milion EURO
2. Energolinija LLC	31.9 milion EURO
3. Georgian American Alloys, Inc	26.5 milion EURO
4. Konsorciumi Calik Enerji dhe Adacami Enerji	15.8 milion EURO

Vlerësimi paraprak i dokumentacionit tregoi se shumica e investitorëve, në dukje nuk përmbushnin kriteret e kualifikimi dhe/ose dokumentacioni i paraqitur nuk përputhej me kërkesat formale dhe të përmbajtjes së ofertës teknike e financiare sipas Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit.

Për pasojë, më datë 4 Janar 2013, Koordinatorit Projektit pranë METE-s i dërgoi investitorëve një kërkesë për sqarime mbi dokumentacionin e mangët/parregullt. Në vijim të kësaj kërkesë Energolinija dërgoi sqarimet e kërkuara:

Për më tepër, Konsorciumi Calik Enerji ka dërguar një kërkesë për kthimin e garancisë së ofertës së bërë prej tij.

Në bazë të sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson sa vijon:

1. Kurum International Sh.A (Shqiperi)

Investitori plotëson kërkesat e kualifikimit dhe oferta nga ana formale dhe materiale është e plotë. Gjithsesi, në dokumentacionin e ofertës financiare, investitori bashkëlidh një shkresë sipas të cilës shprehet se: *“Oferta jonë është subjekt dhe merr në konsideratë të drejtat financiare të pagueshme, që Shteti Shqiptar ka në formën e TVSH-së së verifikueshme për t’u rimbursuar ndaj ofertuesit, ose ndonjë të tillë (të drejtë) të njohur nga Autoriteti Kontraktues dhe do të përfshihet në negocimin e kontratës”*

Formulimi i ofertës lë të kuptohet se implikon kërkesën për të kompensuar pjesë të çmimit të shitjes së ofruar, me shumën e TVSH-së së rimbursueshme. Ndërkohë që kjo kërkesë është qartësisht jashtë objektit të dokumenteve të privatizimit; e drejta për të kërkuar rimbursimin e TVSH-së, në shumat e konfirmuara nga autoritetet fiskale garantohet sipas ligjit Shqiptar. Në bazë të Procedurave të Tenderimit, ofertat e kushtëzuara nuk pranohen. Gjithsesi, në cilësinë e organit kompetent për miratimin/ndryshimin e Procedurave të Tenderimit, Këshilli i Ministrave mund të vendosë të pranojë ose jo ofertën e Kurum, me të gjitha kushtet e saj.

2. Energolinija LLC (Bosnjë - Hercegovinë)

Oferta e investitorit paraqet dokumentacion të pamjaftueshëm për kualifikimin e tij dhe garancia e ofertës nuk është në përputhje me kërkesat tenderit, pasi mungon Garancia Bankare (Sigurimi i Ofertës është lëshuar si garanci e korporatës).

Rrjedhimisht, në bazë të Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit, oferta duhet të skualifikohet.

3. Georgian-American Alloys

Oferta e investitorit paraqet dokumentacion të pamjaftueshëm për kualifikimin e tij. Ofertuesi nuk ka paraqitur garancinë e ofertës dhe kopjen e sigluar të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve. Rrjedhimisht, në bazë të Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit, oferta duhet të skualifikohet.

4. Konsorciumi Calik Enerji

Garancia e ofertës nuk është në përputhje me kërkesat tenderit, pasi Sigurimi i Ofertës nuk është konfirmuar nga Banka Shqiptare - përmban formulimin mbi konfirmimin nga BKT të nënshkruesve të autorizuar të METE. Ofertuesi nuk i është përgjigjur kërkesës për sqarime brenda afatit të kërkuar, por ka kërkuar kthimin e Garancisë së Ofertës, çka nuk është në përputhje me Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit. Rrjedhimisht, në bazë të Procedurave të Tenderit dhe Udhëzimeve për Ofertuesit, oferta duhet të skualifikohet.

KOMISIONI I
VLERËSIMIT TË
OFERTAVE

Z.Sokol Dervishaj	kryetar
Z.Alfred Rushaj	anëtar
Z.Dael Dervishi	anëtar
Z.Majlind Lazimi	anëtar
Z.Genti Minarolli	anëtar
Z.Zamir Stefani Moçka	anëtar
Z.Fatmir Isufaj	anëtar
Z.Agim Bregasi	anëtar
Znj.Dhurata Hoxha	anëtare
Z.Petrit Gjoni	anëtar
Z.Eduart Elezi	anëtar
Znj.Doris Çarçani	anëtar
Z.Gazment Bardhi	anëtar